



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MAT**  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Burrel, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR – PUNË”**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Mbrotjtja nga përroi i Urakës, Nj.A Rukaj, Bashkia Mat (Faza 1)”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**45210000-2** Punime ndërtimi.

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**50 064 348.15** (pesëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e dyzet e tetë pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2024 në vlerën: 17 522 522 (shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2025 në vlerën: 32 541 826.15 (tridhjetë e dy milion e pesëqind e dyzet e një mijë e tetëqind e njëzet e gjashtë pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Mat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1, dhe Listën e Çmimeve (sipas zërave të preventivit) sipas Shtojcës 2;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

*Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).*

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

### Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

**b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**

**3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.**

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 100 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021, 2022, 2023) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-

së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ndërsa bilancet duhet të paraqiten nga secili anëtar.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likjuar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

**Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.**

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;  
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** e fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon :
- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
  - ii. Situacionin përfundimtar të objektit dhe situacionet progressive/pjesore*
  - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
  - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
  - v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
  - vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
  - vii. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
- vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/c dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”*

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 5 dhe 8** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore **dhe çdo lloj**

*dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

**8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”**

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

**Njësia përcaktoj kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.**

**Referuar natyrës së kontratës për punë publike, njësia vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacionit ligjor të zbatimit të punimeve, bazuar në ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”** (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b të VKM-së, të paraqesin dhe kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit (*si dhe çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve*), për të vërtetuar faktin, nëse operatori ekonomik pjesëmarrës zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës në masën e përcaktuar sipas nenit 39 pika 5 të VKM-së, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të paraqitet dhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre, pasi në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, si dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

**Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së**

prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
  - **Kategoria NP-1** (Punime gërmimi në tokë) – **Klasifikimi A**
  - **Kategoria NP-9** (Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime) – **Klasifikimi B**
  - **Kategoria NP-12** (Punime të inxhinierisë së mjedisit) – **Klasifikimi A**
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
  - **Kategoria NS-9** (Punime strukturorë speciale) – **Klasifikimi A**
  - **Kategoria NS-18** (Punime topogjeodezike) – **Klasifikimi A**

\* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

\* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.

2.3.3 **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:**

- **ISO 9001** (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë) e përditësuar
- **ISO 14001** (Për sistemin e menaxhimit të mjedisit) e përditësuar
- **ISO 45001** (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
- **ISO 3834-2: 2006** (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
- **ISO BS EN 13331-1: 2002** (Për realizimin e punimeve për veshjet e kanaleve dhe skarpatave të ndryshme), ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave dhe objekti i së cilave duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj

duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme.

2.3.5 **Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:**

- **Hekur betoni**
- **Rrjete/tel i zinguar per rrethime, gabiona etj**

**Operatori ekonomik duhet të paraqesë:**

**1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar**, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, dhe të jetë i vlefshëm vetëm për këtë objekt deri në realizimin e plotë të punimeve.

**2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

***Shënim:*** *Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

**3. Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme.**

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një kontratë noteriale shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar, me afat vlefshmërie në përputhje me afatin e kryerjes së punimeve dhe e vlefshme vetëm për objektin e kësaj kontrate, për analizat e mëposhtme:

- Beton i freskët sipas standardeve SSH EN SSH EN 12350-2:2019, ose sipas standardeve të përditësuara.
- Beton i ngurtësuar sipas standardeve SSH EN 12390-8:2019; SSH EN 12504-2:2021, ose sipas standardeve të përditësuara



- Hekur sipas standardit SSH EN ISO 6892 – 1:2019, ose sipas standardeve të përditësuara.

### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/a, 2 dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” (i ndryshuar) në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;**... **c) aftësinë teknike dhe profesionale;**...

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

**2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.**

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 2, 4, 6 dhe 8** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

**“2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.**

**4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**

**6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:**

**a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose**

**b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës;**

**8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”**

Në nenin 40 pika 6/ b dhe c të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

Gjithashtu në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

1. Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), neni 8 i tij në të cilin përcaktohet se, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm subjekte të licensuar, sipas kësaj rregulloreje, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë licencën profesionale për zbatimin e punimeve, me **kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, ku sipas preventivit të punimeve OE duhet të disponojnë: kategorinë NP-1 (Punime gjermimi në tokë)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv për punimet e sistemimit të jashtëm (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi > 2 m, prani uji, kategoria III, me shk. në tokë); **kategorinë NP-9 (Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime)** e cila përfshin të gjitha zërat e punimeve në preventiv për punimet e mbrojtjes lumore; **kategorinë NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit)** në lidhje me punimet që do të kryhen, pasi janë punime të cilat kryhen dhe kanë ndikim në mjedis; **kategorinë NS-9 (Punime strukturorë speciale)** në lidhje me zërat e punimeve të strukturave të betonit (F.V. hekur betoni..., Struktura monolite betoni... etj.), si dhe **kategorinë**

**NS-18 (Punime topogjeodezike)** - duke qënë se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike, është e nevojshme zotërimi dhe i kësaj pike liçense, **si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.**

2. Njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime, ku më hollësisht:

- ISO 9001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta;
- ISO 14001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit;
- ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.
- ISO 3834-2, është një standart i rëndësishëm dhe kryesor që duhet të disponojnë ofertuesit në këtë objekt prokurimi, pasi ai përcakton kushtet që duhet të përmbushin ndërmarrjet për të zbatuar praktikatat e mira në proceset e saldimit, ku duke qënë se cilësia e punimeve në lidhje me punimet e saldimit nuk mund të verifikohet lehtë, kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor si garanci që ofertuesit të vërtetojnë se disponojnë aftësitë e nevojshme për kryerjen e punimeve të saldimit të një cilësie të mirë dhe të qëndrueshëm, duke shmangur situatat e nevojës për riparimin e difekteve, ku si rrjedhojë do të sillte vonesa në përfundimin dhe vënien në efijencë të investimit.
- ISO BS EN 13331-1 2002, është kërkuar me qëllim vërtetimin se, në lidhje me natyrën e punimeve objekt prokurimi, siç është ajo e gërmimeve për hapjen e themeleve, operatorët ekonomik pjesëmarrës sigurojnë qëndrueshmërinë e mureve vertikale të mbrojtjes dhe të mbrojnë punëtorët nga efektet e shembjes së tyre, duke garantuar vendosjen e materialeve për ndërtimin e themeleve dhe murit mbrojtës sipas specifikimeve të kërkuara. Ky certifikimi konfirmon faktin që ofertuesi ka informacionin e nevojshëm për përcaktimin dhe përdorimin e sigurt të murit mbrojtës.

3. Referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (*dheu, kanale*), dhe kryerjen e transportit të tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “*Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte*” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “*Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”.**
4. Po ashtu, njësia e prokurimit bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t’i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.
5. Gjithashtu, referuar rëndësisë që ka investimi objekt prokurimi, ku do të kryhen punime të cilat duhet të kenë rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike, si depot e ujit, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” (i ndryshuar) neni 4 dhe 14 i tij, **ku sanksionohet ndër të tjerash se në rastet kur materialet e ndërtimit janë prodhuar në vend, duhet të pajisen me çertifikatë cilësie nga laboratorë të akredituar**, si dhe Udhëzimit Nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*” Kreu II pika 3 i tij, në të cilin përcaktohet se, citojmë: “*3. Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme vendosen në vepër kur janë shoqëruar me certifikatë cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vërtetojnë ose vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me standardet, që referohen në përshkrimet dhe specifikimet teknike.*”, **njësia e prokurimit vlerëson t’u kërkojë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që të disponojnë një kontratë shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar, për kryerjen e analizave të produkteve që do të vendosen në objektin e prokurimit, si: *Beton i freskët, Beton i ngurtësuar, dhe Hekur sipas standardit***, sipas Listës të standarteve të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.98, datë 06.02.2013 “*Për miratimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e konformitetit për produktet e ndërtimit*” në zbatim të ligjit Nr.9290, datë 07.10.2004 “*Për produktet e ndërtimit*” (i ndryshuar).

**Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me**

**objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.**

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **50 (pesëdhjetë) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

2.3.8 **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:**

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni **2 (dy) Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë/ ura)**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Gjeoteknik)**
- Minimuni **2 (dy) Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Mjedisi**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Gjeolog**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

b) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi **32 (tridhjetë e dy) punonjës** të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi – jo më pak se **3 (tre)** punonjës

- Specialist karpentier – jo më pak se **6 (gjashtë)** punonjës
- Specialist murator – jo më pak se **6 (gjashtë)** punonjës
- Hekurkthyes – jo më pak se **6 (gjashtë)** punonjës
- Betonues – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Gurpunues – jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Saldator – jo më pak se **4 (katër)** punonjës
- Mekanik – jo më pak se **2 (dy)** punonjës

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.				
2.				
etj.				

\* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7.

- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.108, datë 09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.*

- d) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjës që përmbush kriteret për të qenë “Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë” gjatë realizmit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi

të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar /licencuar/ certifikuar shqiptar ose i huaj.

- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë përkatëse të lëshuar nga Drejtoria MZSH/ekuivalente.
- f) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të certifikuar për *“Punime në prani uji”*, i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, Diplomë/ certifikate, dhe Libreze pune.
- g) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të certifikuar për *“Përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001:2015”*, i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, Diplomë/ certifikate, dhe Libreze pune.
- h) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Libreze pune (përkatëse)
  - CV përkatëse
  - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
  - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi

**3** (tre) shoferë të mjeteve të rënda (të cilët duhet të disponojnë leje drejtimi me kategorinë “C” dhe/ose “CE” dhe/ose “D” dhe/ose “DE”), dhe **8** (tre) manovratorë/ eskavatoristë/ automakinist, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.7 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.**

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/b** dhe **c** dhe **8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:**

**b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose**

**c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;**



**8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”**

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e një punësimi mesatar jo më pak se **50 (pesëdhjetë) punonjës**, duke përfshirë stafin teknik, punonjësit e specializuar/ certifikuar dhe drejtuesit e mjeteve/makinerve është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 39 pika 6/c të VKM-së, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve teknike*” dhe afatit të kryerjes së punimeve (5 muaj) të përcaktuar në dokumentat e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për plotësimin e dokumentacionit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.
2. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, pasi mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve njësia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me**

**kualifikimet e kërkuara.** Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivit të punimeve (*nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik*), ku më hollësisht parashtrojmë:

- Janë kërkuar minimuni 2 (*dy*) Inxhinier Ndërtimi, pasi referuar projektit të objekt prokurimit, kemi ndërtimin e 2 (*dy*) mureve mbrojtëse në vendodhje të ndryshme përgjatë lumit, ku lind e nevojshme që të angazhohen 2 (*dy*) inxhinier ndërtimi që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e tyre, pasi punimet (*gërmimi, betonimi, strukturat monolite dhe ato me gabiona... gurë kave*) do të kryhen njëkohësisht në 2 (*dy*) fronte, ku gjithashtu do të jenë të angazhuar dhe me ndjekjen e dokumentacionit dhe korespondencave në lidhje me objektin e investimit;
- Është kërkuar minimuni 1 (*një*) Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastrukturë/ ura, pasi referuar natyrës së punimeve objekt prokurimi, mbrojtje lumore me mur gabioni dhe mbushje me zhavorr, ku ngjitur me murin ndodhet dhe rruga rurale automobilistike, lind e nevojshme që këto punime të kryhen nën mbikqyerjen e inxhinierit me këtë profil, me qëllim marjen e masave të nevojshme inxhinierike që muri dhe mbushja me zhavorr të jetë e qëndrueshme dhe të ketë siguri për automjetet e transportit;
- Është kërkuar minimuni 1 (*një*) Inxhinier Ndërtimi, profili Gjeoteknik, pasi brigjet e lumit ku do të ndërtohen muret me gabion, kanë një gjatësi të konsiderueshme dhe shtrihen në terren kodrinor me formacione toke të ndryshme, disa segmente/ seksione prej të cilave janë edhe të rrëshqitshme. Për këtë arsye është e nevojshme mbikqyrja e punimeve dhe marrja e masave inxhinierike të nevojshme për formacionet e paqëndrueshme;
- Janë kërkuar minimuni 2 (*dy*) Inxhinier Hidroteknik, pasi ky objekt ka për qëllim ndërtimin e mureve me gabion për mbrojtjen e brigjeve lumore dhe ka një gjatësi të konsiderueshme, është e nevojshme që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e inxhinierëve. Gjithashtu duke qenë se është objekt ku do të punohet në 2 (*dy*) fronte, lind e nevojshme që të jenë të paktën 2 (*dy*) inxhinierë hidroteknik në ndjekjen e punimeve, ku njëri prej tyre do të jetë i angazhuar dhe me ndjekjen e dokumentacionit dhe korespondencave në lidhje me objektin e investimit;
- Është kërkuar minimuni 1 (*një*) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder, pasi do të kryejë azhornimin topografik dhe piketimin e mureve mbrojtëse si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bejë edhe azhornimin faktit (as built);
- Është kërkuar minimuni 1 (*një*) Inxhinier Mjedisi, pasi duke qenë se punimet do të kryhen në mjedis të pasur me drurë, shkurre, bimësi etj., ku do të ndërtohen muret mbrojtës, nëpërmjet gërmime në thellësi të tokës, lind e domosdoshme disponimi i këij inxhinieri me qëllim shmangien e dëmtimit të panevojshëm të mjedisit dhe burimeve në të, pasi mbrojtja e mjedisit gjatë kryerjes së punimeve ka një rëndësi shumë të lartë;
- Është kërkuar minimuni 1 (*një*) Inxhinier Mekanik, pasi referuar tonazhit dhe llojeve të automjeteve/ makinerive që do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate, ka nevojë që dislokimi dhe drejtimi i tyre të mbikqyret nga ana e inxhinierit mekanik, duke qenë se terreni ku do të kryhen punimet është i papërshtatshëm (shtrat lumi me prani uji) dhe lartësi të konsiderueshme. Gjithashtu inxhinieri mekanik do të mbikqyrë edhe ecurinë e mjeteve të gërmimit, të transportit etj., të cilat do të përdoren për punimet e këtij objekti;

- Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeolog, pasi referuar projekt-preventivit të këtij investimi kemi punime gërmimi të themeleve ku do të kryhet struktura monolite betoni, dhe muret mbajtëse të mbrojtjes lumore, ku inxhinieri gjeolog është i nevojshëm për përcaktimin kategorisë së dherave dhe formacionin tokësor në të cilat mund të kryhen këto punime me qëllim mbajtjen e peshës së mureve dhe mosdëmtimin e tyre;

ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

3. Po ashtu, referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, si: **Teknik ndërtimi**., ku krahas dokumentave të tjera të kërkuara, është e rëndësishme që për vërtetimin e aftësive të tyre, të paraqiten diplomat e shkollës së mesme. Gjithashtu krahas teknikëve, referuar natyrës, specifikës dhe volumit të punimeve që do të kryhen, për realizimin e tyre në përputhje me standartet teknike të zbatimit dhe brenda afatit të përcaktuar, njësia e prokurimit vlerëson të nevojshëm disponimin e **punonjësve të kualifikuar, të cilët duhet të jenë me specialitetin: Karpentier, Murator, Hekurkthyes, Betonues, Gurpunues, Saldator, Mekanik**, pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, ku për vërtetimin e disponimit të tyre është kërkuar plotësimi dhe paraqitja e të dhënave sipas tabelës të përcaktuar, dhe paraqitja e dokumentacionit, dëshmitë/ certifikatat e kualifikimit të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, si dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit teknik për punën në ndërtim**, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.
4. Në lidhje me marrjen e masave për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në zbatim të nenit 23 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” në të cilin përcaktohet se, citojmë: “1. Çdo punëdhënës i një subjekti publik apo privat, vendas apo i huaj, është i detyruar të mbulojë me shërbim mjekësor, nëpërmjet mjekut të punës, të përshtatshëm për rreziqet që paraqet vendi i punës.”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar me VKM-në nr.632, datë 15.07.2015), në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:... b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili: b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune; b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit;...” **duke qënë se është detyrim ligjor mbulimi me shërbim mjekësor të ndërmarrjes nga ana e punëdhënësit, dhe mbulimi i këtij shërbimi në aspektin shëndetësor duhet të kryhet nga mjeku i punës i licencuar, njësia e prokurimit vlerëson se, kërkesa për disponimin e mjekut të ndërmarrjes ose të**

**kontraktuar është një detyrim ligjor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në përputhje me ligjin, duhet vërtetojnë disponimin e tij, i cili duhet të jetë i punësuar për periudhën e kërkuar, në përputhje me periudhën që është kërkuar punësimi i fuqisë punëtore kërkuar më lart.**

5. Në lidhje me kërkesën për disponimin si pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjës që përmbush kriteret për të qenë **“Përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”** gjatë realizimit të punimeve, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi **nevojitet për përshtatjen e kantierit sipas fazave të punimeve, mbajtjen e kantierit në kushte të rregullta, kontrollin e materialeve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë dhe ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe verifikimin e zbatimit të planit të sigurisë dhe koordinimit gjatë zbatimit të punimeve** kërkesa kjo në zbatim të nenit 9 dhe 10 të ligjit të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”*, dhe nenit 2, 5 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”*.
6. Në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (një) specialisti ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 *“Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”*, në të cilin përcaktohet se, **personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimit e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktim-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.**
7. Në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të certifikuar për *“Punime në prani uji”*, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit dhe një punonjës i cili duhet të jetë i trajnuar për punime në prani uji, **pasi vendndodhja ku do të kryhen punimet objekt kontrate, kanë prani uji të lumit, dhe lind e domosdoeshme disponimi i këtij punonjësi për kryerjen e punimeve, me qëllim shmangien e rrezikut të aksidenteve në punë të punonjësve që mund të vinë nga prania e ujit.**
8. Në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (një) punonjës të certifikuar si *“Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë sipas standartit ISO 9001: 2015”*, vlerësohet si kërkesë e nevojshme, pasi duhet që një punonjës të jetë i specializuar në sigurinë dhe kontrollin e cilësisë në lidhje me punimet që do të kryhen dhe mallrat/materialat që do të furnizohen dhe vendosen në objektin e prokurimit, ku, referuar rëndësisë së veçantë që ka investimi objekt prokurimi, **vlerësohet me rëndësi fakti që të disponohet një punonjës me këto njohuri të posaçme mbi kontrollin e cilësisë, pasi duke qënë prezent gjatë gjithë periudhës së punimeve ai vlerëson dhe kontrollon cilësinë e çdo punimi dhe materiali që kryhet dhe vendoset në objekt,** kërkesë kjo e cila i shërben A.K. për vërtetimin se operatori ekonomik jep garanci se punimet objekt prokurimi do të jenë brenda standarteve të kërkuara.

9. Po ashtu, me qëllim ndërtimin e objekt kontratës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion, në zbatim të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, **i cili duhet të jetë i përfshirë në licencimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryen punimet në objekt**, kjo dhe në rastin kur ofertuesi merr pjesë si bashkim i operatorëve ekonomik, secili anëtar duhet të përcaktojë/ deklarojë drejtuesin teknik të punimeve, si dhe të paraqesë dokumentacionin e kërkuar.
10. Gjithashtu, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet që të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për disponimin në stafin e tyre, e të paktën **3 (tre)** shoferë të mjeteve të rënda (të cilët duhet të disponojnë leje drejtimi me kategorinë “C” dhe/ose “CE” dhe/ose “D” dhe/ose “DE”), dhe **8 (tetë)** manovratorë/ eskavatoristë/ automakinist, të cilët duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara, me qëllim transportimin e materialeve dhe inerteve si dhe gërmimeve për kryerjen e punimeve objekt kontrate, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. Në përcaktimin e numërit të punonjësve shoferë dhe manovratorë, është përcaktuar duke patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen (gërmime, mbushje, rrafshime etj.) përfshirë dhe transportin e materialeve dhe inerteve, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

**Punonjësit, specialistët, inxhinierët dhe stafi i kualifikuar të kërkuar i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t’u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.**

#### 2.3.10 (Makineri, Pajisje)

- a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;**

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Makinerisë/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min. 20 ton	jo më pak se 4 copë
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12 - 18 ton	jo më pak se 2 copë
4.	Kamion me Vinç	jo më pak se 2 copë
5.	Kamionçinë	jo më pak se 3 copë
6.	Rimorkiator për lëvizjen e mjeteve	jo më pak se 1 copë
7.	Eskavator me goma	jo më pak se 2 copë
8.	Eskavator me zinxhir	jo më pak se 2 copë

9.	Eskavator me zinxhir me çekic pneumatik	<i>jo më pak se 1 copë</i>
10.	Fadromë me goma	<i>jo më pak se 2 copë</i>
11.	Minieskavator	<i>jo më pak se 1 copë</i>
12.	Minifadromë	<i>jo më pak se 1 copë</i>
13.	Autobetoniere	<i>jo më pak se 2 copë</i>
14.	Betoniere 0.25 – 0.5 m <sup>3</sup>	<i>jo më pak se 3 copë</i>
15.	Autopompë Betoni	<i>jo më pak se 2 copë</i>
16.	Autobot uji	<i>jo më pak se 1 copë</i>
17.	Rul ngjeshës gomë - cilindër	<i>jo më pak se 2 copë</i>
18.	Vibrator Betoni	<i>jo më pak se 4 copë</i>
19.	Makineri Prerëse Betoni	<i>jo më pak se 1 copë</i>
20.	Armaturë Kallëperi betoni	<i>jo më pak se 500 m<sup>2</sup></i>
21.	Pompë Uji	<i>jo më pak se 2 copë</i>
22.	Matrapik	<i>jo më pak se 2 copë</i>
23.	Gjenerator	<i>jo më pak se 2 copë</i>
24.	Saldatriçe	<i>jo më pak se 3 copë</i>
25.	Tokmak Elektrik për ngjeshje dheu	<i>jo më pak se 2 copë</i>
26.	Motosharrë për prerje bimësie	<i>jo më pak se 1 copë</i>
27.	Aparat për kthim dhe prerje hekuri	<i>jo më pak se 1 copë</i>
28.	GPS	<i>jo më pak se 1 copë</i>
29.	Total Station	<i>jo më pak se 1 copë</i>

- b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:
- Kokore – *jo më pak se 50 copë*
  - Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
  - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 5 copë*
  - Prozhektorë ndriçimi natën – *jo më pak se 7 copë*
  - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 15 copë*
- **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**
- 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
  - 2- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*),

Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.

- 3- Për pajisjet/ makineritë në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- Për pajisjet/ makineritë me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 5- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranoje verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- 6- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklarohet se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) kantier për prodhimin e betonit dhe 1 (një) kantier për prodhimin e inerteve në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi (*Kontrata Noteriale e Qerasë/Furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate*), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë*) dhe kontratën noteriale të qerasë/ furnizimit në rast se kantieri është me qera ose kontratë furnizimi.
- Leje Mjedisi nga QKL, sipas ligjit në fuqi.
- Dokumentacioni (*deklarata*) doganore dhe /ose fatura tatimore që vërteton pronësinë e linjës (*makineri/pajisje*) për prodhim betoni dhe inertesh.

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/d të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ... d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

1. Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhen punimet dhe transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimit teknike objekt kontrate**, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve, ku një operator ekonomik pa këto mjete e pajisje nuk mund t’i realizojë këto punimeve. Gjithashtu në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, **njësia e prokurimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate**. Njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës me qëllim vërtetimin e disponimit të tyre, dhe dokumentacionin tekniko-ligjor për automjetet të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik për qarkullimin e tyre.
2. Gjithashtu, referuar punimeve objekt prokurimi, njësia e prokurimit vlerëson se, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë disponimin e 1 (një) kantier për prodhimin e betonit dhe 1 (një) kantier për prodhimin e inerteve në pronësi, ose me qera ose me kontratë furnizimi, **pasi kjo i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët janë të aftë të sigurojnë sasinë e nevojshme të materialeve që do të përdoren në investim, si dhe sigurinë e cilësinë të mallrave/ produkteve**, duke qënë se kemi të bëjmë me produkte të cilat duhet të prodhohet nga prodhues të licencuar etj., kërkesë kjo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi, ku në lidhje me përmbushjen e këtij kushti, njësia e prokurimit ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit ligjor në mbështetje të ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar), ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Dokumentacioni për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës disponon vetë (pronësi/qera) kantierin, ose ka nënshkruar një kontratë furnizimi me një subjekt i cili disponon vërtet kantierin për prodhimin e betonit dhe inerteve, pasi ky është dokumentacioni ligjor që vërteton ekzistencën e kantierit, në rast të kundërt nuk do vërtetohej dot nëse kontrata e furnizimit është lidhur me një subjekt i cili e disponon këtë kantier. Paraqitja e dokumentacionit përveç se nuk



përbën kosto për operatorin ekonomik pjesëmarrës, por duhet të jetë pjesë dhe e kontratës që nënshkruhet, me qëllim vërtetimin se pala furnizuese është prodhuese e këtij malli.

### 2.3.12 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Analizat e çmimeve të preventivit, Plan – organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt, me një relacion shpjegues sipas kërkesave të përcaktuara nga KPT dhe KTZ në fuqi, si dhe Grafikon e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

#### **Argumentimi:**

Referuar vlerës dhe natyrës së punimeve që ka ky investim objekt prokurimi, **me qëllim vërtetimin se operatorët ekonomik ofertues kanë paraqitur një ofertë reale, të bazuar në një studim të hollësishëm të Projekt - preventivave**, njësia e prokurimit vlerëson se ofertuesit si pjesë e ofertës ekonomike duhet të paraqesin dhe analizën e çmimeve të preventivit që kanë kryer, dokument i cili nuk përbën kosto shtesë, përkundrazi dëshmon se kanë dhënë një ofertë të përgjegjshme. Gjithashtu, bazuar në përcaktimet e **nenit 15 pika 3** e VKM-së Nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), duke qenë se investimi objekt prokurimi shtrihet në afërsi të parcelave të tokave bujqësore të banorëve, dhe rrugëve rurale automobilistike **me qëllim që të mos ketë dëmtime në këto ara (toka bujqësore), dhe pengesa në lëvizjen e qarkullimit e mjeteve, të banorëve etj.**, njësia e prokurimit vlerëson se, op. ek. pjesëmarrës duhet të bëjnë dhe të paraqesin një plan organizimi i mirëfilltë të punimeve. Plani i organizimit të punimeve duhet të fillojë që me ngritjen e kantierit të objektit, rrugët e aksesit për në kantier, depozitimin e materialeve për ndërtimin e objektit, parkimin e mjeteve të punës, vendosjen e zyrës së kantierit, objektimi i linjave dhe depos, rrethimin e kantierit, vendosjen e tabelave të sinjalizimit, zbatimin e masave tekniko - organizative të objektit, masat e ndihmës së shpejtë etj. Pra, për kryerjen e punimeve për ndërtimin e objektit duhet patjetër të bëhet një plan organizim punimesh me qëllim që punimet të jenë sipas rradhës së duhur dhe të koordinuara në kohë dhe cilësi. Plani i organizimit të punimeve **gjithashtu është i rëndësishëm dhe për zbatimin e punimeve sipas grafikut të punimeve**, ku njësia e prokurimit referuar të dhënave teknike të projektit, ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej 5 (pesë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

#### **Shënim:**

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s’kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përjashtim bën vetëm Katalogu për materialet e kërkuar, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në shkresën **Nr.Prot.2569, datë 01.07.2024** “Kërkesë për objektin: “Mbrojtja nga përroi i Urakës, Nj.A Rukaj, Bashkia Mat (Faza 1)” dërguar nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Pronave/ Bashkia Mat, ku bashkëlidhur ka dërguar *Projekt – Preventivin, Relacionin, Grafikun e punimeve dhe Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi të kryera nga një shoqëri e licensuar në projektim, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik<sup>1</sup>” (i ndryshuar), dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 07.08.2024, ora 10.00**, vendi: në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) .

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

### **NJËSIA E PROKURIMIT**